



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 26.01.2023

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT TË
JOJETËS “ANSIG” SH.A., SI REZULTAT I RRIJTJES SË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 4, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit themeltar, me këtë përmbajtje:**

“Neni 4, Kapitali themeltar”

Kapitali themeltar i shoqërisë është 874, 305, 000 lekë (tetëqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e pesë mijë lekë), i ndarë në 87, 430 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10, 000 lekë secili, sipas strukturës më poshtë:

Struktura e Aksioneve

	Në vlerë nominale
Numri i aksioneve	87, 430
Vlera nominale e aksioneve	10, 000
Piro Angjeli	59, 452
Edlir Ruka	8, 743
Llazar Angjeli	19, 235

Në lekë	
Piro Angjeli	594, 527, 400
Edlir Ruka	87, 430, 500
Llazar Angjeli	192, 347, 100
Kapitali Shoqërisë	874, 305, 000

Në % pjesëmarrje	
Piro Angjeli	68 %
Llazar Angjeli	22 %
Edlir Ruka	10 %

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Departamenti i Licencimit, Mbrojtjes Konsumatore dhe Sjelljes së Tregut, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE